# PAKETA FISKALE - VITI 2017

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA BELSH**

**Nr______Prot** **Belsh më ____.____.2016**

VENDIM

**Nr._01__.datë._13__._01_.2017**

Konfirmuar me shkresen 45/1 prot. te prefektit te qarkut date 25/01/2017.

## PËR NIVELIN E TAKSAVE VENDORE,KUNDRAVA]TEVE ADMINISTRATIVE DHE GJOBAVE NË BASHKINË BELSH, SI DHE PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË TYRE.

Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",neni 32,gërma "f", ligjit nr. 142/2015, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632 Datë 30.10.2006, "Për sistemimin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë",ligjit nr 179/2013 datë 28.12.2013 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920,datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar si dhe VKM nr.970 datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj". ; Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise" i azhornuar; Ligjit nr.8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; dhe te gjitha akteve te tjera nenligjore per zbatimin e ligjeve te sipërcituara.

## ZYRA E TATIM - TAKSAVE I PROPOZON KËSHILLIT TË BASHKISË:

I.Të miratojë nivelet e taksave dhe tarifave për vitin 2017 në Bashkinë Belsh si më poshtë:

**A) TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:**

1- Takso mbi ndërtesën

Belsh , Rruga "Haziz Dervishi" Email:bashkiabelsh@hotmail.com

*2- Taksa mbi tokën bujqësore*

*3- Taksa mbi truallin*

## *B)TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË*

*1- Për ndërtime të reja*

*2- Për objektet në process legalizimi*

*3- Për autorizime punimesh*

## *C)TAKSA DHE TARIFA TË TJERA VENDORE*

*1- Tarifa për pastrimin*

*2- Tarifë për zënien e hapsirës publike*

*3- Taksa e tabelës*

*4- Tarifë për lëshimin e vërtetimeve dhe autorizimeve ditore të transportit*

*5- Tarifa për ndriçimin publik*

*6- Tarifë për gjelbrim*

*7- Tarifë për zgjatje orari "Non Stop"*

*8- Tarifë për liçencë për tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre*

*9- Tarifë për shërbimin veterinar*

*10- Tarifa për dokumenta nga urbanistika*

*11- Tarifë për dhënien në përdorim të ambjenteve*

*12- Taksa e truallit*

## *D) TARIFA VENDORE TË PËRKOHSHME*

*1- Tarifë vjetore për baste sportive,lojra fati etj.*

*2- Tarifë për vaditje*

## *E) TARIFA PËR TRANSPORTIN.*

## F) GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

# a-Taksa mbi pasurinë e paluajtshme:

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme perfshihen:

1. Taksa mbi ndërtesën
2. Taksa mbi tokën bujqësore
3. Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj,mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi dhe ne rastin e mungesës se dokumentacionit, Këshilli i Bashkisë ngre komisionin e verifikimit te pasurive te paluajtshme i cili verifikon madhësinë e sipërfaqes se tatueshme. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si dokumentacion nje nga dokumentacionet e meposhteme :

a) vërtetimin e pronësisë

b) vendimet e komisionit te kthimit te pronave c) vendimet e privatizimit

d) vetëdeklarimin e ndertimit pa leje, te shoqeruar me genplan nga nje inxhinier i licensuar.

e) vendimet e komisionit te verifikimit te pasurive te paluajtshme.

f) Kontrate qeraje brenda afateve te vlefshmerise se saj.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë ose komunës vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshm.

Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë ose komunës.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda këssaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë. Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si vijon:

## 1- Taksa mbi ndërtesat/banesat

Tabela 1.1

| | **Tabela 1.1** | |
|---|---|---|
| **Nr** | **Emërtimi** | **Niveli I taksës** |
| 1. | Ndërtesa banimi para vitit 1993 | 5 leke/m2/vit |
| 2. | Ndërtesa banimi të ndërtuara gjatë dhe pas vitit 1993 | 6 leke/m2/vit |
| 3. | Për shtëpitë e dyta | 12 leke/m2/vit |
| | | |
| 4. | Ndërtesa për tregti dhe shërbime | 200 lekë m2/vit |
| 5. | Ndërtesë jo në shfrytëzim | 40 lekë m2/vit |
| 6. | Ndërtesa për tregti dhe shërbime për njësitë administrative të tjera si dhe për veprimtari prodhuese | 100 lekë m2/vit |

Shënim: Për vjeljen e taksës së banesës për të gjitha familjet që banojnë në Bashkinë Belsh të trajtohen me një sipërfaqe mesatare prej 80 m2 për familje. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së banesës është Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Belsh (UKB) që nga viti 2017.

## 2-Taksa mbi token bujqësore

***Tabela 1.2***- Për taksën e tokës bujqësore i propozojmë Këshillit Bashkiak uljen e taksës në nivelin 70%,mbështetur në ligjin 9632, "Për sistemimin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjin 142/2015.

| | **Tabela 1.2** | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Klasifikimi sipas kategorive të tokës** | **Vlera 100%/Hektar** | **Vlera 70%/Hektar =(70 % X Vlerën 100%/Hektar)** |
| **1.** | Kategoria I | 4200 Lekë | 2940 Lekë |
| **2.** | Kategoria II | 3500 Lekë | 2450 Lekë |
| **3.** | Kategoria III | 2800 Lekë | 1960 Lekë |
| **4.** | Kategoria IV | 2300 Lekë | 1610 Lekë |
| **5.** | Kategoria V | 1900 Lekë | 1330 Lekë |
| **6.** | Kategoria VI | 1600 Lekë | 1120 Lekë |
| **7.** | Kategoria VII | 1400 Lekë | 980 Lekë |

Shënim:Parcelat të cilat nuk kanë të dhëna boniteti,apo për të cilat nuk ka një kategori të përcaktuar,të trajtohen me kategorinë mesatare të zonës ku ndodhen.

3- Taksa mbi Truallin:

| **Klasifikimi I taksës** | **Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët** | **Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi** |
|---|---|---|
| **Tarifa** | 0,14 lekë/m2 | 12 lekë/m2 |

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme

## b -Taksa mbi ndikimin në infrastrukture:

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet.Klasifikimi investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në perputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve është si mëposhtë:

| | | |
|---|---|---|
| **1** | **Kategoritë e objekteve** | **Vlera e taksës** |
| | | |
| | Objekte banimi | 1 % |
| | Objekte shërbimi dhe industriale | 3 % |
| | | |
| **2** | Objekte që janë në proces legalizimi | 0.5 % |

Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 % të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut,

sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

3-Taksa e ndikimit në infrastrukturë për punime me autorizim dhe që sipas ligjit nuk kanë të nevojshme marrjen e lejes së ndërtimit:

| 3 | **Lloji i punimeve** | **Vlera / vit** |
|---|---|---|
| | Punime me vetëdeklarim dhe që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi. | 5000 lekë |
| | Autorizim për meremetime të vogla dhe që nuk kanë nevojë për leje ndërtimi sipas dispozitave ligjore në fuqi. | 2000 lekë |

## C)TAKSA DHE TARIFA TË TJERA VENDORE

### 1.Tarifa për pastrimin:

| Nr | Xhiro Vjetore e Biznesit / Njësi shërbimi / Institucione shtetërore | Niveli i taksës/Vit | |
|---|---|---|---|
| * | *Për popullatën* | *1000 Leke* | |
| | | *Belsh Qëndër* | *Njësi administrative dhe periferi.* |
| | **LLOJI I AKTIVITETIT** | **Tarifa/njësi shërbimi** | **Tarifa/njësi shërbimi** |
| **1.** | Biznes i vogël,Bar Kafe,Restorant,Tregti industriale,Tregti ushqimore,Minimarket,Sherbime. | 5 000 | 3 000 |
| **2.** | Furrë Buke,Tregti mishi, Farmaci veterinare, Farmaci Bujqesore, Stomatolog. | 6 000 | 4 000 |
| **3.** | Përpunim mermeri,përpunim druri dhe alumini,servis. | 6 000 | 5 000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **4.** | Tregti ushqimore me shumicë,Supërmarket | 20 000 | 15 000 |
| **5.** | Karburant | 20 000 | 15 000 |
| **6.** | Biznesi i madh i lëndëve të ndërtimit,nxjerrje dhe përpunim mineralesh dhe gurore. | 25 000 | 15 000 |
| **7.** | Njësi shitje gazi për përdorim familjar | 9 000 | 5 000 |
| **8.** | Biznesi i madh i tregtimit me shumicë dhe pakicë i lëndëve industriale. Mobileri,Alumin,Hidrosanitare. | 20 000 | 10 000 |
| **9** | Farmaci | 20 000 | 10 000 |
| **10** | Institucione publike,Banka,biznese të mëdha vip,Subjektet e kabllorit dhe internetit. | 30 000 | 30 000 |

1.1.Tarifë pastrimi për subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet liqenore për të kryer aktivitetin ripopullim,zënie dhe tregtim peshku:

| Nr | Sipërfaqja e liqenit që shfrytëzohet | Lekë/vit |
|---|---|---|
| 1 | 0.1-20 ha | 10.000 lekë |
| 2 | 20.1-50 ha | 20.000 lekë |
| 3 | Mbi 50 ha | 30.000 lekë |

1.2.Tarifë pastrimi për subjektet e transportit:

| Nr | Lloji i mjetit,subjektit | Tarifa /vit |
|---|---|---|
| 1. | Për taksi 4+1,minibus,autobuz | 5 000 lekë |
| 2. | Për transport malli deri në 5 ton | 2 500 lekë |
| 3. | Për transport malli 5-8 ton | 3 500 lekë |
| 4. | Për transport malli 8-12 ton | 4 000 lekë |
| 5 | Për transport malli mbi 12 ton | 5 000 lekë |

**2.Tarifë për zënien e hapsirës publike (jo truall):**

| | Zënie e hapsirës publike | Tarifa |
|---|---|---|
| 1 | Zënie e hapsirës publike gjatë zhvillimit të tregut të lirë,organizimi i spektakleve dhe panairëve të ndryshëm. | 50 lekë m2/ditë |

| | | |
|---|---|---|
| **2** | Zënie e hapsirës publike për një periudhë të caktuar kohe,në vënde të përcaktuara. | 60 lekë/m2/muaj |
| **3** | Për bar-kafe,restorante,që shfrytëzojnë hapsirën publike me tavolina. | 50 lekë /ditë për një tavolinë |

## 3. Taksa e tabelës:

| Nr | Emertimi | Niveli i taksës |
|---|---|---|
| 1. | Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. | 0 lekë |
| 2. | Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim. | 120 lekë/vit |
| 3. | Tabelë e thjeshtë | 13 500 lekë/ m2/vit |
| 4. | Tabelë elektronike | 27 000 lekë/ m2/vit |
| 5. | Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. | 1000 lekë/m2/ditë |

## 4. Tarifë për lëshimin e vërtetimeve dhe autorizimeve ditore të transportit:

| **Nr** | **Emertimi** | **Niveli i taksës/lekë** |
|---|---|---|
| 1. | Vertetim | 100 lekë |

## 5. Tarifa për ndriçimin publik:

| | **Emertimi** | **Niveli I taksës/Vit** | |
|---|---|---|---|
| | | Belsh Qëndër | Njësi administrative dhe periferi |
| 1 | Për biznese të vogla me xhiro vjetore deri në 5000.000 lekë | 1000 lekë | 800 lekë |
| 2 | Për biznese të mëdha me xhiro vjetore mbi 5000.000 lekë dhe institucione shtetërore | 3500 lekë | 2500 lekë |
| 3 | Për popullatën | 500 lekë | 500 lekë |

- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

Shënim: Tarifa për ndriçimin publik paguhet vetëm nga ata banorë, subjekte dhe biznese që u ofrohet ky shërbim.

### 6. Tarifa për gjelbrim:

| **Nr** | **Emertimi** | **Tarifa/lekë** |
|---|---|---|
| **1** | Për popullatën | 200 lekë |
| **2** | Për bizneset nga 0-5000 000 lekë | 500 lekë |
| **3** | Për bizneset mbi 5000 000 lekë | 1000 lekë |

### 7. Tarifë për zgjatje orari "Non Stop" :

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Për zgjatje orari 24-h (non-stop) | 5000 lekë |

### 8. Tarifë për liçencë për tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre:

Bazuar mbi vendimin nr. 970, datë 2.12.2015 ,"Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj". Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 2 000 000 (dy milionë) lekë për bashkinë Belsh.

### 9. Tarifë për shërbimin veterinar:

| **Nr** | **Emërtimi** | **Njësia** | **Tarifa** |
|---|---|---|---|
| 1 | Therje për cdo bageti të trashë | Kokë | 200 lekë |
| 2 | Therje për cdo bagëti të imët | Kokë | 100 lekë |

Shënim: Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet sektori i veterinarisë pranë bashkisë.

### 10. Tarifë për dhënien në përdorim të ambjenteve:

| **Nr** | **Emërtimi** | **Tarifa/ditë** |
|---|---|---|
| **1** | Dhënie në përdorim e shtëpisë së kulturës për aktivitete partiake | 20.000 lekë |
| **2** | Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete kulturore dhe fetare | 5.000 lekë |
| **3** | Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete Shkollore | 0 |

## d) Tarifa vendore të përkohshme:

| Nr | **Lloji I tarifës** | **Tarifa** |
|---|---|---|
| 1 | Taksë vjetore për Lojra fati,Kazino,Kazino elektronike, baste sportive. | 20 000 lekë/vit |
| 2 | Tarifë për vaditje | 200 lekë/dylym |

## e) Tarifa për transportin:

| NR | EMERTIMI | NJËSIA | TARIFA/1 VIT |
|---|---|---|---|
| | TRANSPORT UDHËTARËSH | | |
| **1** | Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt qytetëse | Për licencë | 8 000 lekë/vit |
| **2** | Certifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt qytetëse | Për mjet | 1 000 lekë/vit |
| **3** | Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt rrethqytetëse | Për licencë | 4 000 lekë/vit |
| **4** | Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt rrethqytetëse | Për mjet | 1 500 lekë/vit |
| **5** | Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut | Për licencë | 15 000 lekë/vit |
| **6** | Certifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut | Për mjet | 1 500 lekë/vit |
| **7** | Licencë për transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve | Për licencë | 15 000 lekë/vit |
| **8** | Certifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve | Për mjet | 1 500 lekë/vit |
| **9** | Li çencë për agjensi udhëtarësh | Për liçencë | 15 000 lekë/vit |
| | TRANSPORT MALLRASH | | |
| **1** | Certifikatë transporti malli për të tretë dhe me qera vjetore | Për mjet | 3 000 lekë/vit |
| **2** | Certifikatë transporti malli për llogari të vet | Për mjet | 1 500 lekë / vit |
| **3** | Çertifikatë për tërheqës dhe makineri shpimi | Për mjet | 7 500 lekë/vit |
| **4.** | Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vëndit për mjete deri 5 ton | Për mjet | 10 000 lekë/ vit |
| **5.** | Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vëndit për mjete 5 deri 8 ton | Për mjet | 12 000 lekë vit |
| **6.** | Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vëndit për mjete mbi 8 ton | Për mjet | 15 000 lekë/vit |
| | TARIFË VJETORE PARKIMI/QËNDRIMI | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| 1. | Për taksi 4+1,taksi 8+1 dhe minibus deri në 25 vënde | Për mjet | 5000 lekë/vit |
| 2. | Për autobuz mbi 25 vënde | Për mjet | 9000 lekë/vit |
| 3. | Për transport malli deri 5 ton | Për mjet | 3000 lekë/vit |
| 4. | Për transport malli 5-8 ton | Për mjet | 4000 lekë/vit |
| 5. | Për transport malli 8- 12 ton | Për mjet | 5000 lekë/vit |
| 6. | Për transport malli mbi 12 ton | Për mjet | 6000 lekë /vit |
| 7. | Tarife parkimi e rezervuar | Për mjet | 15 000 lekë /vit |
| 8 | Tarifë parkimi ditor | Për mjet | 50 lekë /ditë |
| | | | |
| | TARIFA TË TJERA TRANSPORTI | | |
| 1. | Autorizim ditor | Për mjet | 1 00 lekë/ditë |
| 2. | Autorizim i përkohshëm mujor | Për mjet | 2000 lekë/muaj |
| 3. | Leje ditore për hyrje në qytet | Për mjet | 5 00 lekë/ditë |
| 4. | Leje mujore për hyrje në qytet | Për mjet | 2000 lekë /muaj |
| 5. | Leje tre mujore për hyrje në qytet | Për mjet | 5000 lekë/muaj |

Shënim.Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet inspektori i transportit pranë Bashkisë Belsh.

## F) GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

| Nr | Lloji I gjobës | Lekë |
|---|---|---|
| * | **Aplikim gjobash për** | |
| 1. | Hedhje mbeturinash në rrugë | 1000-5000 lekë/rast |
| 2. | Kamatëvonesë për bizneset që nuk paguajnë takst vendore brënda afatit 31.06.2017 | 10 % e totalit për të paguar |
| 3. | Gjobë për ndërhyrjen në rrugë e trotuare | 10 000 - 15 000 lekë/rast |
| 4. | Gjobë për ndërhyrje në ndricimin publik | 10 000 - 15 000 lekë/rast |
| 5. | Gjobë për bllokimin e rrugëve të arave | 5 000 - 10 000 lekë/rast |
| 6. | Gjobë për zaptim dhe punim të tokës shtetrore | 5 000 - 10 000 |
| 7. | Gjobë për therje bagëtish në ambjente publike | 1 000 - 5 000 lekë/rast |
| 8. | Gjobë për ndërtim pa leje | 15 000 - 25 000 lekë/rast |
| 9. | Gjobë për ushtrimin e aktivitetit të transportit të udhëtarëve pa liçencë | 1 000 - 5 000 lekë/rast |
| 10. | Hyrja e mjeteve me tonazh të lartë në rrugët kryesore të qytetit pa autorizim | 1 000- 5 000 lekë/rast |
| 11. | Mos pajisje me leje për tregtimin e karburanteve dhe bomblave të gazit | 10000-20000 lekë |
| 12. | Mospajisje me leje për tregti ambulante | 1000-5000 lekë |

Shënim:Për zbatimin e kësaj pike si dhe vjeljen këtye gjobave apo kundravajtjeve administrative ngarkohet sektori i Policisë Bashkiake,Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) si dhe Sektori i veterinarisë pranë bashkisë.

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Bujar BLLOKU**